

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-12/05

Prishtinë, më 17 dhe 21 nëntor 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 104 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

Pjesa e parë:

1. Miratimi i Rezolutës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran.

Pjesa e dytë:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Investimet e Huaja;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dizajnin Industrial;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akreditim;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ushqimin;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institucionet e Kulturës;
8. Shqyrtimi i propozimvendimit për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës;
9. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për Siguri;
10. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media;

11. Përgjigja e kryeministrit të Kosovës për pyetjen e deputetit Ramadan Kelmendi dhe
12. Përgjigja e kryeministrit të Kosovës për pyetjen e deputetit Berat Luzha.

1 Miratimi i Rezolutës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me takimet që kishte pasur me grupet parlamentare dhe përfaqësuesit e partive politike.

Në këto takime është arritur marrëveshja të formohet Grupi i punës, për ta harmonizuar tekstin përfundimtar të rezolutës.

Grupi i punës përbëhet nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, si vijon:

- Fatmir Sejdiu dhe
- Nekibe Kelmendi – GP i LDK-së;

- Hashim Thaçi dhe
- Hajredin Kuçi – GP i PDK-së;

- Gjylnaze Syla – GP i AAK-së;

- Ylber Hysa – GP i ORA-s dhe

- Mahir Yagcillar – GP 6+.

Kryetari dha pauzë dy orësh, gjatë së cilës grupi i punës duhet ta harmonizonte tekstin përfundimtar të Projekt- Rezolutës dhe t’ia paraqiste Kuvendit për miratim.

Pas pauzës, **kryetari** e ftoi deputeten, Nekibe Kelmendi, që në emër të grupi të punës ta paraqiste Projekt- Rezolutën.

Deputetja **Nekibe Kelmendi**, në emër të Grupi të punës, paraqiti Projekt- Rezolutën, si vijon:

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të kreut 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese;

- Duke u mbështetur në Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të Drejtën e Popujve për Vetëvendosje dhe aktet e tjera ndërkombëtare;
- Duke marrë parasysh aspiratën legjitime të popullit të Kosovës për të jetuar i lirë dhe në paqe me popujt tjerë;
- Duke u mbështetur në zhvillimet historike, juridike e kushtetuese të Kosovës, të shprehur në Konferencën e Bunjajt (1943-44), në Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990, në Referendumin e vitit 1991, si dhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran të vitit 1991;
- Duke u bazuar në luftën e gjatë të popullit të Kosovës për liri e pavarësi;

- Duke u bazuar në rezistencën e përgjithshme ndaj okupimit dhe në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
- Duke konfirmuar garantimin për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë sipas standardeve ndërkombëtare;
- Duke u bazuar në programet e partive politike për statusin politik të Kosovës;
- Duke e çmuar lart intervenimin e NATO-s në Kosovë për të ndalë gjenocidin dhe pastrimin etnik në Kosovë nga ana e Serbisë, si dhe ndihmën ndërkombëtare dhënë Kosovës;

Kuvendi i Kosovës nxjerr

REZOLUTË

PËR RIKONFIRMIMIN E VULLNETIT POLITIK TË POPULLIT TË KOSOVËS PËR KOSOVËN SHITET TË PAVARUR DHE SOVRAN

1. Kuvendi i Kosovës rikonfirmon vullnetin e popullit të Kosovës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran;
2. Kuvendi i Kosovës garanton rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për Pavarësi nëpërmjet Referendumit;
3. Kuvendi i Kosovës merr obligim të nxjerrë Kushtetutën e Kosovës në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian;
4. Kuvendi i Kosovës kërkon përkrahjen ndërkombëtare për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran, nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, si dhe nga vendet e tjera;
5. Kuvendi i Kosovës shpreh gatishmëri që t'i ratifikojë të gjitha konventat dhe aktet e njohura ndërkombëtare, mbi të drejtat e njeriut dhe mbi të drejtat e komuniteteve, që dalin prej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian;
6. Kuvendi i Kosovës zotohet për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut për qytetarët e Kosovës dhe të drejtave të komuniteteve minoritare në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare;
7. Kuvendi i Kosovës angazhohet që Kosova të integrohet në strukturat Evropo-Atlantike, mirëpret angazhimin e tyre të mëtejme në Kosovë, dhe angazhohet për raporte të mira me vendet fqinje duke kontribuar për stabilitetin e rajonit;
8. Kuvendi i Kosovës garanton tërësinë territoriale të Kosovës dhe pacenueshmërinë e kufijve të saj;
9. Kuvendi i Kosovës konfirmon se vullneti i popullit të Kosovës për Pavarësi është i panegocueshëm;
10. Kuvendi i Kosovës duke e mbështetur Delegacionin e Kosovës, do të përcjellë gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim për të ardhmen e Kosovës do të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet Referendumit.

Kjo Rezolutë paraqet bazën juridike dhe politike për platformën e Delegacionit të Kosovës për pavarësinë e Kosovës.

Kuvendi njëzëri (me aklamacion) e **miratoi** Rezolutën për rikonfirmimin e vullnetit politik të Popullit të Kosovës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran.

Kryetari e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 15:15 minuta.
Më 21 nëntor 2005
Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Të pranishëm ishin 83 deputetë.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Investimet e Huaja

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Propozuesi i projektligji, ministri Bujar Dugolli, kërkoi që Komisioni funksional t'i tërheq disa amendamente të propozuara për këtë projektligj.

Fatmir Rexhepi, kryetar dhe Bajrush Xhemajli, nënkryetar të Komisionit funksional, thanë shumica e amendamenteve të propozuara nga komisioni e përmirësojnë cilësinë e Ligjit, por mund të diskutohet për ndonjë.

Kryetari i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Komisioni Funksional i tërhoqi amendamentet: 13 dhe 25.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----79;
Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për Investimet e Huaja.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dizajnin Industrial

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----72

Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Dizajnin Industrial.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akreditim

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----73

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **miratoi** Ligjin për Akreditim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ushqimin

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyente këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim zëvendësministri **Hajdaraj**, shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Hajdaraj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lulzim Zeneli, Afrim Arzuallxhiu, Ymer Halimi, Fatmire Mulhaxha, Rifat Krasniqi, Behxhet Brajshori, Shpresa Murati, dhe Naim Jerliu**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 74;
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për Ushqimin. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Komisionin për Punë, Shëndetësi dhe Çështje Sociale - Komisione përgjegjëse për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

Kryetari dha pauzë një orësh.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Në mungesë të ministrit përkatës, për ta arsyetuar Projektligjin para deputetëve të Kuvendit, shqyrtimi i këtij projektligji i shty për seancën e radhës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institucionet e Kulturës

Në mungesë të ministrit përkatës, për ta arsyetuar Projektligjin para deputetëve të Kuvendit, shqyrtimi i këtij projektligji i shty për seancën e radhës.

7. Shqyrtimi i propozimvendimit për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit me përfundimin e Kryesisë lidhur me nismën e Grupit Parlamentar të AAK-së për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës.

Kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë nismë.

Opinione dhe sugjerime lidhur me nismën e Grupit parlamentar të AAK-së për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës dhanë këta deputetë: **Sabri Hamiti, Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylaj, Mhahir Jakxhillar, Teutë Sahatçia dhe Fatmir Sejdiu**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70;
Kundër-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri

V E N D O S I

1. Miratohet nisma për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës;
2. Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me grupet parlamentare t'ia propozojnë Kuvendit Grupin e Punës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës.

8. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për Siguri

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit me përfundimin e kryesisë lidhur me kërkesën e Komisionit për Emergjencë dhe Gatishmëri për formimin e Komisionit për Siguri.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë përfundim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur këtë propozim dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Fatmir Sejdiu, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylaj dhe Ylber Hysa**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** tha se kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës.

9. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Medi

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit për formimin e Komisionit ad hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e Këshillit të Komisionit të pavarur për Media.

Kryesuesi i hodhi në votë propozimet e përfaqësueseve të partive politike, të përfaqësuara në Kuvend. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----79;
Kundër----- 6.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Parlamentar ad hoc

I Formohet Komisioni Parlamentar ad hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave.

II Komisioni përbëhet prej përfaqësueseve të partive politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, si vijon:

1. Fatmir Sejdiu	-	LDK
2. Fehmi Mujota	-	PDK
3. Ymer Halimi	-	AAK
4. Ylber Hysa	-	ORA
5. Oliver Ivanoviq	-	SLKM
6. Mark Krasniqi	-	PSHDK
7. Emrush Xhemaji-		LPK
8. Bislim Hoti	-	IRDK
9. Zylfi Merxha	-	PREBK
10. Mahir Jagxhilar	-	KDTP
11. Xhezair Murati	-	VAKAT
12. Rrustem Ibish	-	GIG
13. Numan Baliq	-	SDA
14. Gjergj Deda	-	PLK
15. Sabit Rrahmani	-	PDAK.
16. Zlatica Kojungjiq	-	DPKM
17. Ferid Agani-		PD

III Komisioni i rekomandon Kuvendit listën për emërimin e anëtarëve të Këshillit jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas vlerësimit të tyre nga Komisioni

11. Përgjigja e kryeministrit të Kosovës për pyetjen e deputetit Ramadan Kelmendi

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit **Ramadan Kelmendi**.

12. Përgjigja e kryeministrit të Kosovës për pyetjen e deputetit Berat Luzha

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit **Berat Luzha**.

Deputeti Berat Luzha tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen e kryeministrit dhe kërkon nga ai përgjigje me gojë, ashtu siç e ka parashtruar.

Kryesuesi konstatoi se kjo çështje shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 14:10 minuta.

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**